

UDHËZIM
Nr. 888, datë 29.10.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 33, DATË 20.12.2023, “PËR MËNYRËN
E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 161, DATË
21.3.2018, ‘PËR PAGESËN E SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA’”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 24, të vendimit nr. 161, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 33, datë 20.12.2023, “Për mënyrën e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 21.3.2018, ‘Për pagesën e së ardhurës nga papunësia’”, të ndryshuar, shkronja “a” e pikës 3, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“a) Të gjithë personat, të cilët kanë kontribuar si punëmarrës në sigurimet shoqërore, për një periudhë të paktën 12-mujore, për çdo rast përfitimi”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja